



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR  
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL “SHËRBIME MJETESH  
TRANSPORTI”,**

**(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)**

**TIRANË, 2024**

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Shërbime mjetesh transporti**”, **Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK**, individët i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në zbatim të udhëzimit “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional”.

**Programi orientues** për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional ”**Shërbime mjetesh transporti**”, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të individëve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

### **Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin ”**Shërbime mjetesh transporti**”, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**a) Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

<b>Nr.</b>	<b>Kompetencat profesionale</b>	<b>Detyrat e punës</b>	<b>Pikët</b>
1	Të realizojë punime të diagnostikimit në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të automjetit.	<b>Detyra 1:</b> Punime të diagnostikimit në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të automjetit.	20
2	Të realizojë punime të diagnostikimit në njërin nga sistemet e motorit me djegie të brendshme (sistemit të vajisjes, të ftohjes, të ushqimit, të ndezjes ose të lëshimit)	<b>Detyra 2:</b> Punime të diagnostikimit në motorin e automjetit	15

3	Të realizojë punime të diagnostikimit në njërin nga elementët e sistemit të transmetimit të fuqisë së automjetit.	<b>Detyra 3:</b> Punime të diagnostikimit në sistemin e transmetimit të fuqisë	15
4	Të realizojë punime të diagnostikimit në njërin nga sistemet e drejtimit dhe të frenimit të automjetit.	<b>Detyra 4:</b> Punime të diagnostikimit në sistemin e drejtimit dhe të frenimit	15
5	Të realizojë punime në njërin nga sistemet moderne të automjeteve. (sistemet moderne të sigurisë së automjeteve, orientimit, komfortit etj.).	<b>Detyra 5:</b> Punime në sistemet moderne të automjeteve.	15
6	Të realizojë shërbime në njërin nga sistemet e makinave elektrike dhe hibride (te sistemi elektrik i tensionit të lartë, bateria, sistemi i karikimit etj.)	<b>Detyra 6:</b> Punime në makinat elektrike dhe hibride	20
<b>Shuma</b>			<b>100</b>

**b) Skema e vlerësimit me nota:**

<b>Pikët e fituara</b>	<b>Notat</b>
<b>0 - 40</b>	<b>4</b>
<b>41 - 50</b>	<b>5</b>
<b>51 - 60</b>	<b>6</b>
<b>61 - 70</b>	<b>7</b>
<b>71 - 80</b>	<b>8</b>
<b>81 - 90</b>	<b>9</b>
<b>91 - 100</b>	<b>10</b>

**Shënime:**

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “detyra pune”, në bazat e praktikave pranë shkollave profesionale për të gjitha ato procese, që garantojnë në mjediset e saj. Për procese që nuk garantojnë në bazën e praktikave të shkollës, ato mund të realizohen në mjediset reale pune (servise), që garantojnë kushtet për realizimin e tyre.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se **3 orë**, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi.
- Është e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme që për çdo detyrë, në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesin (organizatorët e provimit) t’i kushtohet vëmendje Respektimit të Rregullave të Sigurimit Teknik dhe Mbrojtjes së Mjedisit gjatë gjithë kryerjes së detyrave për çdo nxënës.
- Gjithashtu, duhet t’i lihet hapësirë bashkëbisedimit profesional, ku komisioni drejton pyetje të parapërgatitura për proceset kyçe, por dhe në çdo rast kur e shikon të arsyeshme që duhet të ndërhyjë me pyetje, sepse bashkëbisedimi profesional është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara më sipër.
- Për çdo detyrë komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet e vlerësimit të detajuara, p.sh listë kontrolli, duke pasur parasysh programin e zhvilluar në këtë nivel, për të gjitha modulet e detyruara të praktikës profesionale, sipas kompetencave përkatëse të përfshira në skeletkurrikul.

- Instrumentet e vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijnë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, higjienizimin e vendit dhe mjeteve të punës, etj. Gjithashtu, është e rëndësishme të vlerësohet realizimi i standardeve dhe respektimi i procesit në kohë.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.
- Për çdo detyrë komisioni i provimit përfshin në vlerësim edhe disa kompetenca të përgjithshme, të cilat janë të rëndësishme, si vetëkontrolli, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme, komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi etj.
- Është e rëndësishme, që nxënësit të pajisen me një material udhëzues, ku të përcaktohen detyrat që do të kryejnë, mënyra e vlerësimit të tyre, koha që duhet të kenë në dispozicion. Gjithashtu, mund t'u jepen tabela ndihmëse, ku paraqiten vlera për matje të caktuara sipas detyrave përkatëse, etj.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit. Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Realizimi i Detyrës 1: Punime të diagnostikimit në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të automjetit** do të kryhet në mjediset e praktikës profesionale duke përdorur kompjuterin për diagnostikimin e parregullsive në sistemin elektrik, elektronik dhe kompjuterik të automjetit. Nxënësi kryen analizat paraprake për diagnostikimin e sistemit elektrik, elektronik dhe kompjuterik të automjetit; Nxënësi duhet të kryejë kontrollin dhe matjet e duhura dhe të përcaktojë parregullsitë në njërin nga sistemet: të baterisë; sistemit të lëshimit; sistemit të furnizimit me rrymë elektrike të automjetit; sistemit të ndezjes së përzierjes djegëse; sistemit të ndriçimit dhe të sinjalizimit të automjetit. Nxënësit i vihen në dispozicion materialet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kësaj detyre, si kompleti i veglave, instrumentet matës, automjeti mësimor, katalogë, manuale, kompjuter për diagnostikim etj. Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit, bën matjet përkatëse për gjetjen e parregullsisë të elementit të përcaktuar nga komisioni. Nxënësi punon në mënyrë individuale dhe të pavarur dhe vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e punës që kryen. Ai do të vlerësohet më anë të listës së kontrollit. Nxënësit duhet të realizojnë përzgjedhjen, porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për automjetet duke përdorur programe digjitale.

**Për realizimin e Detyrës 2: Punime të diagnostikimit në motorin e automjetit**, nxënësi do të punojnë në mënyrë individuale. Kjo detyrë do të kryhet në mjediset e praktikës profesionale ku realizohet diagnostikimi i sistemeve të automjetit. Atyre u jepen të paktën **dy** punime diagnostikimi për një nga sistemet (sistemi i vajosjes, ftohjes, ndezjes ose ushqimit)

ose mekanizmat e motorit (mekanizmi bjellë-manivelë, mekanizmi i shpërndarjes së gazeve );

Nxënësit i vihet në dispozicion koha e përshtatshme për realizimin e detyrës si dhe mjetet e pajisjet e nevojshme, si, katalogë, manuale, kompleti i veglave, instrumentet, automjeti mësimor, kompjuter për diagnostikimin e motorit etj. Ai pasi bën përzgjedhje e tyre dhe pasi lexon udhëzimet përkatëse, përcakton elementet e parregullt në motor. Kryen matjet dhe kontrollin e nevojshme duke i krahasuar ato me katalogun përkatës dhe fillon realizimin e detyrës për gjetjen e parregullsive e elementeve të parregullt. Nxënësi vëzhgohet nga komisioni vlerësues në të gjitha hapat e kryerje të detyrës. Ai vlerësohet me anë të listës së kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Nxënësit duhet të realizojnë përzgjedhjen ,porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për automjetet duke përdorur programe digjitale.

**Për realizimin e Detyrës 3: Punime të diagnostikimit në sistemin e transmetimit të fuqisë së automjetit,** nxënësit i jepen të kryejë të paktën **dy** prej punimeve të këtyre sistem. Realizimi i kësaj detyre do të bëhet në mjediset e praktikës profesionale ku realizohet diagnostikimi i elementeve të sistemit të transmetimit të fuqisë së automjetit. Nxënësi do punojë në mënyrë individuale. Atij i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e domosdoshme, si, kompleti i veglave, instrumentet matës, automjeti mësimor, agregate, katalogë, manuale, kompjuter për diagnostikimin etj. Nxënësi pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit, të parregullsive në elementet e sistemit të transmetimit të fuqisë së automjetit të përcaktuara nga komisioni. Ai vëzhgohet nga komisioni në çdo hap pune që kryen. Ai do të vlerësohet për punimet e kryera, për diagnostikimin e parregullsive në elementet e sistemit të transmetimit të fuqisë së automjetit me anë të listës së kontrollit. Nxënësit duhet të realizojnë përzgjedhjen ,porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për automjetet duke përdorur programe digjitale.

**Për realizimin e Detyrës 4: Punime të diagnostikimit në sistemin e drejtimit dhe të frenimit**” nxënësit i jepen të kryejë të paktën **dy** prej punimeve të diagnostikimit në sistemet e drejtimit dhe të frenimit. Realizimi i kësaj detyre do të bëhet në mjediset e praktikës profesionale ku realizohet diagnostikimi i elementeve të sistemeve të drejtimit dhe të frenimit të automjetit. Nxënësi do punojë në mënyrë individuale. Atij i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e domosdoshme, si, kompleti i veglave, instrumentet matës, automjeti mësimor, agregate, katalogë, manuale, kompjuter për diagnostikimin etj. Nxënësi pasi bën përzgjedhjen e tyre, kryen procesin e diagnostikimit, të parregullsive në elementet e sistemit të drejtimit dhe sistemit të frenimit të automjetit të përcaktuara nga komisioni. Ai vëzhgohet nga komisioni në çdo hap pune që kryen. Ai do të vlerësohet për punimet e kryera, për diagnostikimin e parregullsive në elementet e sistemit të drejtimit dhe sistemit të frenimit të automjetit me anë të listës së kontrollit. Nxënësit duhet të realizojnë përzgjedhjen, porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për automjetet duke përdorur programe digjitale.

**Realizimi i Detyrës 5: Punime në sistemet moderne të automjeteve** do të kryhet në mjediset e praktikës profesionale në shkollë ose në servise private. Nxënësi punon në mënyrë individuale. Ai duhet të kryejë të paktën **dy** nga punimet në sistemet moderne të automjeteve. Nxënësit i vihet në dispozicion kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për të kryer punime në këto sisteme (sistemet moderne të sigurisë së automjeteve, orientimit, komfortit, sistemet moderne për mbrojtjen e mjedisit etj.) . Ai pasi bën përzgjedhjen e tyre, fillon punën për realizim e detyrës së dhënë. Vëzhgohet nga komisioni në çdo hap pune dhe vlerësohet me anë të listës së kontrollit. Nxënësit duhet të realizojnë përzgjedhjen, porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për automjetet duke përdorur programe digjitale.

**Realizimi i Detyrës 6: Punime në makinat elektrike dhe hibride** do të kryhet në mjediset e praktikës profesionale në shkollë ose në servise private. Nxënësit i përcaktohen nga komisioni punimet përkatëse dhe i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e domosdoshme, kompleti i veglave dhe instrumenteve për të kryer punime në makinat elektrike dhe hibride (punime të sistemit elektrik të tensionit të lartë, te bateritë dhe sistemi i karikimit, punime në sistemin e transmetimit, të menaxhimit termik dhe të frenave rigjeneruese). Ai kryen matjet dhe kontrollet e nevojshme duke i krahasuar ato me katalogun përkatës dhe fillon realizimin e detyrës për zëvendësimin e elementeve të dëmtuar. Kjo detyrë do të zhvillohet në repartet e shërbimit të automjeteve duke zbatuar të gjitha rregullat për sigurinë në punimet në automjetet hibride dhe elektrike me tension të lartë. Ai punon në mënyrë individuale dhe do të vlerësohet me anë të listës së kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Nxënësit duhet të realizojnë përzgjedhjen, porositjen dhe shitjen e pjesëve të këmbimit për automjetet duke përdorur programe digjitale.